

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ LIQUORE 2023 ” SH.P.K

Në Tirane , sot me datë 04/12/2023 (dymijë e njezetetre), redaktohet ky Akt Themelimi I Shoqërisë Private me Përgjegjësi të Kufizuar “ **LIQUORE 2023**“ SHPK nga une kerkuesi :

- **Z. Amadeo CUEDARI** , i biri Perparimit , dtl. 02/01/2001 , banues ne Berat me adrese ; Lagja 30 Vjetori Berat , i identifikuar , në bazë të Kartës së Identitetit me Nr.038762731 dhe nr personal K10102045A.

I cili, bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare të Ndryshuar” dhe nenet përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë në fuqi, nëpërmjet këtij Akti Themelimi, themeloi Shoqërinë “” SH.P.K, e cila përbëhet nga nenet e mëposhtme:

KREUI

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti

Neni 1
Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **SH.P.K.**

Neni 2
Forma Juridike

Shoqëria “**LIQUORE 2023**” SH.P.K, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Shoqëria “**LIQUORE 2023**” SH.P.K, është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe ortakut përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka selinë në adresën: Tirane, Tirane, TIRANE, Lagjja “Komuna e Parisit “ Rruga Tish Daija , godine me nr pasurise 5/34, zone kadastrale 8260

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4
Objekti

- ❖ **Import , tregtim me shumice pije alkoolike, vere , dhe aksesore te ndryshem qe jane ne sherbim te tregtimit te pijeve te ndryshme .etj**

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e sajë për një periudhë kohore të pakufizuar.

KREU II

KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 lekë (një qind lekë), i përbërë nga 1 kuote, me vlerë nominale 100. lekë.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga ortaku i shoqërisë, **Z. Amadeo CUEDARI i cili zoteron 100% te pjeseve te kapitalit .**

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajteshme/të paluajteshme apo të drejta.)

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një Administrator.

- Administrator i shoqërisë është **znj.Xhesika HIMI** , e bija e Besnikut , dtl. 17/07/2003, në bazë të Kartës së Identitetit me Nr037721078,me nr.personal K35717001W .
- Administratori do të ushtrojë detyrat e tij sipas statutit dhe ligjit për një periudhë **5 vjeçare** me të drejtë ripërtëritje.

Neni 7
Kompetencat

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësoje shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Neni 8 **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Neni 9 **Bilanci i shoqërisë dhe dividendet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakëve, Miraton Bilancin e paraqitur nga Administratori

Mbledhja e Ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 10 **Dispozita përfundimtare**

Mos marreveshjet që mund të lindin midis ortakut të vetem, administratorit dhe personave të tjerë të ppunësuar në shoqëri në rast se nuk zgjidhen me pajtim do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i ligjshëm i kësaj shoqërie tregtare është në favor të ortakut të vetem të shoqërisë në masën 100%.

Ky Akt Themelimi u redaktua në 4 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, miratohet në parim dhe nën për nën nga Ortakët e Shoqërisë tregtare "**LIQUORE 2023**" SH.P.K dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet.

ORTAKU DHE THEMELUESI I SHOQËRISË
" LIQUORE 2023 " SH.P.K

AMADEO CUEDARI